



Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

VENDIMIN

PËR

PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE SHQIPTARE DHE TË HUAJA, ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË SHTETEVE TË HUAJA DHE MEDIAVE PËRMES PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË VËZHGUESVE

Referuar nenit 19 paragrafi 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit të sipërcituar, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve huaja dhe mediave përmes platformës elektronike të vëzhguesve”

Ky projektvendim vjen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10019 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe në reflektim të plotë të rolit dhe rëndësisë së vëzhguesve zgjedhorë, në çdo fazë të procesit zgjedhor.

Mirëpërcaktimi i procedurave të akreditimit, të drejtave dhe detyrave të vëzhguesit si dhe rregullave tërësore të vëzhgimit të zgjedhjeve, mundësojnë përmbushjen me profesionalizëm të detyrës nga ana e tyre duke rritur kështu transparencën dhe besimin e publikut në procesin zgjedhor.

Ky vendim ka në përbërjen e tij 10 nene.

Neni 1 përcakton qëllimin e këtij projekt vendimi, rregullat për akreditimin, të drejtat, detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Neni 2 përcakton kategoritë e subjekteve zgjedhore që kanë të drejtë të aplikojnë, për të qenë vëzhgues.

Neni 3 përcakton në mënyrë të detajuar procedurën e paraqitjes së kërkesës për akreditimin e OJF-ve shqiptare dhe të huaja, përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe mediave.

Vendimi përcakton se kërkesat e OJF-ve shqiptare dhe të huaja, përfaqësuesve të shteteve të huaja dhe mediave së bashku me dokumentacionin përkatës regjistrohen në KQZ përmes platformës elektronike nga ku merret dhe akreditimi i tyre.

Më tej një vëmendje e veçantë i kushtohet dhe përgjegjësi të kategorive të vëzhguesve, afateve të paraqitjes së kërkesave të tyre për vëzhgues si dhe kohëzgjatja e vëzhgimit.

Vendimi përcakton mënyrën e identifikimit të vëzhguesve pranë qendrave të votimit dhe pajisjen e vëzhguesve me autorizimin përkatës, i cili përgatitet dhe jepet nga KQZ-ja, përmes modulit.

Neni 7 dhe 8 përcakton të drejtat dhe detyrat shtesë për vëzhguesit krahas atyre të përcaktuara në nenin 7, paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor.

Neni 9 dhe 10 parashikon shfuqizimin e akteve të mëparshme në lidhje me vëzhguesit dhe hyrjen në fuqi të këtij projekt vendimi.

Elvira GAXHOLLI- Shef sektori, Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit
Ermina ALLUSHI- Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit
Madalena KOJA- Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA- Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: . .2024

Nr:

Ora: 00:00

VENDIM

PËR

**PROCEDURAT E AKREDITIMIT DHE RREGULLAT E VËZHGIMIT TË
ZGJEDHJEVE NGA ORGANIZATAT JOQEVERITARE SHQIPTARE DHE
TË HUAJA, ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE, PËRFAQËSUES TË
SHTETEVE TË HUAJA DHE MEDIAVE PËRMES PLATFORMËS ONLINE
TË VËZHGUESVE**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

Neni 1

Objekti

Ky vendim përcakton rregullat për akreditimin, të drejtat, detyrat, kriteret dhe standardet për vëzhgimin e zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe mediave përmes përdorimit të Platformës Elektronike të Vëzhguesve.

Neni 2

Kategoritë e subjekteve zgjedhore

Kategoritë e subjekteve zgjedhore që kanë të drejtë të aplikojnë dhe plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për akreditim në zgjedhjet nëpërmjet Platformës Elektronike të Vëzhguesve, janë si vijon:

- organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja,
- organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin,

Data: 24.5.2024 Nr:52
Ora:12:00



“Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”

- përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe
- përfaqësuesit e mediave.

Neni 3

Dokumentacioni për akreditimin e vëzhguesve

1. OJF-të shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe media, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të regjistrohen dhe ngarkojnë në Platformën Elektronike të Vëzhguesve dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesë nga drejtuesi apo përfaqësuesi i organizatës/medias që kërkon të vëzhgojë procesin zgjedhor. Kërkesa përmban adresën, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të kontaktit të aplikuesit.
 - b) Vërtetimin e regjistrimit në gjykatë (të përditësuar 3-6 muajt e fundit) ose në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe/ose ftesën përkatëse. Për akreditimin e gazetarëve të huaj depozitohet dokumenti i vlefshëm i akreditimit nga MEPJ.
2. Listën e veçantë për vëzhguesit afatgjatë/afatshkurtër/përkthyesit e propozuar/përfaqësuesit e medias të propozuar, pasi të jenë regjistruar dhe miratuar si subjekt në platformën online të vëzhguesve. Aplikuesi për t'u akredituar si vëzhgues mban përgjegjësi për saktësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe për të dhënat personale të paraqitura për secilin prej vëzhguesve të propozuar. Dokumentacioni i kërkuar për akreditim ngarkohet në Platformën Elektronike të Vëzhguesve nga personi i autorizuar nga drejtuesi i subjektit.
3. Në rastet kur OJF-të shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe media, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet nuk kanë mundësi të regjistrohen online ata mund të dërgojnë dokumentacionin e kërkuar për regjistrim në protokollin e KQZ-së.
4. Regjistrimi në sistem do të kryhet nga KQZ nëpërmjet “Useri Tip” i krijuar për këtë proces. Çdo regjistrimi në sistem pavarësisht nëse kryhet nga vetë subjekti apo nga KQZ, duhet të konsultohet dhe më pas të miratohet apo refuzohet sipas rastit. Vetëm pasi miratohet nga KQZ, subjekti plotëson kushtet për të patur vëzhgues në zgjedhje.
5. Procedurat për aplikim dhe akreditim do të jenë të detajuara dhe të disponueshme në platformën online, duke i dhënë subjekteve udhëzime të qarta.

Neni 4

Verifikimi i dokumentacionit dhe vendimmarrja e KQZ

1. Aplikimet e vëzhguesve do të vlerësohen nga sektori përgjegjës për akreditim. Ky proces do të bëhet përmes modulit online, për të pasur një qasje të lehtë në të dhënat dhe informacionet e aplikuesve.
2. KQZ bën verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe nëse dokumentet janë të plota dhe të nënshkruara bën akreditimin jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre.

3. Nëse dokumentet për akreditimin, janë jo të plota ose të pasakta KQZ i kërkon aplikuesit të bëjë korrigjimet e vëna në dukje dhe të ringarkojë dokumentet brenda 24 orëve nga njoftimi. Aplikuesi nuk akreditohet nëse nuk ridërgon dokumentacionin e korrigjuar brenda afatit.
4. Pas marrjes së vendimit për akreditim, KQZ pajis vëzhguesit me autorizimin e akreditimit, sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi në lidhjen nr. 1.
5. Autorizimi për vëzhgim është i vlefshëm për zonën zgjedhore, qendra votimi apo vend numërimi të votave, sipas përcaktimit në kërkesën e aplikuesit dhe i jep vëzhguesit të drejtën të hyjë dhe të qëndrojë në ambientet e tyre duke përmbushur të drejtat dhe detyrat e vëzhguesit.

Neni 5

Afatet për regjistrim

1. Aplikuesit shqiptarë, që kërkojnë të vëzhgojnë zgjedhjet, duhet të regjistrohen, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Aplikuesit e huaj duhet të regjistrohen, jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë përpara datës së zgjedhjeve.

Neni 6

Kohëzgjatja e vëzhgimit

1. Vëzhguesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me afatet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Vëzhgues afatgjatë konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin nga momenti i akreditimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
3. Vëzhgues afatshkurtër konsiderohen ata persona, të cilët autorizohen nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin 24 (njëzet e katër) orë para datës së zgjedhjeve deri në përfundimin e procesit të numërimit / shpalljes së rezultateve.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve

1. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, vëzhguesit kanë këto të drejta:
 - a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
 - b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
 - c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor;
 - ç) t'u drejtojnë pyetje komisionit zgjedhor përkatës, pa penguar në veprimtarinë e tij;
 - d) të hyjnë dhe të dalin pa pengesa në ambientet zgjedhore.

2. Vëzhguesit kanë këto detyra:

Data: 00.00.2024 Nr:00
Ora:



“Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediae”

- a) të respektojnë kërkesat e këtij Kodi dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve;
- b) të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti apo koalicion në qendrat e votimit ose në vende të tjera të ndaluara sipas këtij Kodi;
- c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja, si dhe me një dokument identifikimi të pranuar nga KQZ-ja;
- ç) të mos mbajnë shenja dalluese, që shërbejnë si mjete propagande ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
- d) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit, të numërimit dhe administrimit të zgjedhjeve.
- dh) të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor, në procedurat e ditës së votimit, në procesin e numërimit të votave, në procesin e nxjerrjes së rezultatit dhe aktivitetin e komisioneve zgjedhore;
- e) të respektojnë rregullat e etikës në ambientet zgjedhore;
- ë) të mos komentojnë dhe/ose debatojnë vendimet e KQV/KZAZ/GNV dhe procesin e votimit;
- f) të mos marrin ose japin intervista, të mos kryejnë sondazhe me votuesit brenda qendrës së votimit dhe jashtë saj deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) metra distancë nga qendrat e votimit.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e medias së akredituar

1. Vëzhguesit e medias së akredituar krahas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në nenin 6 të këtij vendimi, kanë të drejtë të përdorin kamera në qendrën e votimit por pa ndërhyrë dhe pa penguar procesin e votimit. Ata nuk mund të qëndrojnë në ambientet e qendrës së votimit më shumë se 15 minuta dhe në çdo rast duhet të ruajnë fshehtësinë e zgjedhësit në procesin e tij të votimit.
2. Vëzhguesit e medias së akredituar mund të instalojnë kamera apo pajisje të tjera ndihmëse në vend numërimit të votave dhe mund të transmetojnë ecurinë e procesit të numërimit pa ndërhyrë dhe pa ndikuar në veprimtarinë e KZAZ-së dhe grupeve të numërimit.

Neni 9

Shfuqizime

Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave dhe subjektet zgjedhore”, shfuqizohet.

Neni 10

Data: 00.00.2024 Nr:00
Ora:



“Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve









Ilirjan CELIBASHI

Data: 00.00.2024 Nr:00
Ora:



“Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave”

Lidhja 1

<p>KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p>  <p>VËZHGUES OBSERVER</p>	<p>REPUBLIKA E SHqipëRISE REPUBLIC OF ALBANIA KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p> <p>VËZHGUES OBSERVER</p> <p>Afatgjatë Long Term</p> <p>Emri/Name Mbiemri/Surname Organizata/Organisation Zona/Observation Zone Nr. rendor / Serial No.</p> <p> Ilirjan CELIBASHI Kombëtarë i Drejtues i Zgjedhjeve</p> <p><small>Ky autoritet shqiptarë me një identifikim/Accompanied by ID document</small></p>	<p>KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p>  <p>VËZHGUES OBSERVER</p>	<p>REPUBLIKA E SHqipëRISE REPUBLIC OF ALBANIA KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p> <p>VËZHGUES OBSERVER</p> <p>Afatshkurtër Short-Term</p> <p>Emri/Name Mbiemri/Surname Organizata/Organisation Zona/Observation Zone Nr. rendor / Serial No.</p> <p> Ilirjan CELIBASHI Kombëtarë i Drejtues i Zgjedhjeve</p> <p><small>Ky autoritet shqiptarë me një identifikim/Accompanied by ID document</small></p>
<p>KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p>  <p>VËZHGUES OBSERVER</p>	<p>REPUBLIKA E SHqipëRISE REPUBLIC OF ALBANIA KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p> <p>VËZHGUES OBSERVER</p> <p>Media Media</p> <p>Emri/Name Mbiemri/Surname Organizata/Organisation Zona/Observation Zone Nr. rendor / Serial No.</p> <p> Ilirjan CELIBASHI Kombëtarë i Drejtues i Zgjedhjeve</p> <p><small>Ky autoritet shqiptarë me një identifikim/Accompanied by ID document</small></p>	<p>KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p>  <p>VËZHGUES OBSERVER</p>	<p>REPUBLIKA E SHqipëRISE REPUBLIC OF ALBANIA KOMISIONI QENDOR I ZGJEDHJEVE CENTRAL ELECTION COMMISSION</p> <p>VËZHGUES OBSERVER</p> <p>Përkthyes Translator</p> <p>Emri/Name Mbiemri/Surname Organizata/Organisation Nr. rendor / Serial No.</p> <p> Ilirjan CELIBASHI Kombëtarë i Drejtues i Zgjedhjeve</p> <p><small>Ky autoritet shqiptarë me një identifikim/Accompanied by ID document</small></p>

Data: 00.00.2024 Nr:00
Ora:



“Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediae”